

VENDIM
Nr. 14, datë 16.5.2024

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KOMISIONIT KOMBËTAR
RREGULLATOR NR. 6, DATË 22.2.2023, “PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË
RAJONALE UJËSJELLËS-KANALIZIME DURRËS”**

Në mbështetje të neneve 13, 14, 16 dhe 17 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (ligji nr. 8102); VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë” (VKM nr. 958); si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, “Për procedurat e dhënies dhe të rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike, që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (Rregullore e licencimit),

KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR,

në mbledhjen e datës 16.5.2024, pasi shqyrtoi çështjen me objekt “Mbi miratimin e vendimit ‘Për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar nr. 6, datë 22.2.2023, ‘Për licencimin e Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Durrës’”

VËREN SE:

1. Shoqëria Rajonale Ujësjiellës-Kanalizime Durrës, me shkresën nr. 1338 prot., datë 19.3.2024, me lëndë “Kërkesë për ndryshimin e drejtuesit teknik dhe ligjor”, plotësimet me shkresën nr. 1338/2 prot. datë 22.4.2024, me lëndë “Kërkesë për ndryshimin e të dhënave në licencën e Shoqërisë Rajonale Durrës sh.a.”, si dhe ndryshimet me shkresën nr. 1338/3 prot., datë 10.5.2024, me lëndë “Kërkesë për ndryshimin e të dhënave në licencën e SHRUKD sh.a.”, ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për rinovim të licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesin ligjor dhe një nga drejtuesit teknik të shoqërisë, të shoqëruar me dokumentacionin sipas përcaktimeve të parashikuara në VKM-në nr. 958 dhe rregullores së licencimit, të ndryshuar.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës së Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës-Kanalizime Durrës, për rinovim licence për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor dhe teknik, në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe rregulloren e licencimit, të ndryshuar.

3. KKRR-ja ka licencuar Shoqërinë Rajonale Ujësjiellës-Kanalizime Durrës, me vendimin nr. 6, datë 22.2.2023, “Për licencimin e Shoqërinë Rajonale Ujësjiellës-Kanalizime Durrës, me një afat 4-vjeçar, ku shoqëria autorizohet të ofrojë shërbimin e grumbullimit dhe të shpërndarjes së ujit për konsum publik, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura.

4. Drejtues ligjor i Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës-Kanalizime Durrës, z. Sedi Çausi, është diplomuar në Universitetin Politeknik, në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, me Master shkencor në Hidroteknikë, në vitin 2015.

5. Drejtues teknik i shoqërisë z. Gerald Dautaj është diplomuar në Universitetin Politeknik, në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, me Master shkencor në Hidroteknikë, në vitin 2012 dhe plotëson kërkesat e VKM-së nr. 958 mbi edukimin dhe eksperiencën në profesion;

6. Drejtues i dytë teknik i shoqërisë z. Tonin Doda me titull “Inxhinier Markshajder” është diplomuar në Universitetin Politeknik të Tiranës, Fakulteti Gjeologji-Miniera, Dega Miniera (Specialitet i Markshajderit) në vitin 2012 dhe plotëson kërkesat e VKM-së nr. 958 mbi edukimin dhe eksperiencën në profesion.

7. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për ndryshimin e licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Durrës të kërkesave të ligjit nr. 8102, të VKM-së nr. 958, dhe të rregullores së licencimit, në mënyrë të veçantë sa i takon garantimit që i licencuari të veprojë në përputhje me kushtet e licencës së tij dhe të mbrojë interesat e konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i Shoqërisë Rajonale Ujësjellës-Kanalizime Durrës është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Pika 2 (a) dhe 2 (c) e vendimit të KKRR-së nr. 6, datë 22.2.2023, “Për licencimin e shoqërisë rajonale Ujësjellës-Kanalizime Durrës”, ndryshojnë si më poshtë:

a) Drejtues ligjor: z. Sedi Çaushi;

c) Drejtues teknik: z. Tonin Doda.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani